




Republika e Kosovës
Republika Kosov
Republik of Kosova

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Primjena Me/Date 03-06-2014 god.			
Nr./ organit Org. broj	Numri broj	Shënime Prilog	Vlera Vrednost
01-013/781			



Komuna Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

RREGULLORE

PËR SJELLJE DHE DISIPLINË TË NXËNËSVE PËR SHKOLLAT FILLORE DHE TË MESME TË ULËTA NË KOMUNËN E VITISË

MAJ 2014
VITI

Bazuar në nenin 12.2, shkronja **c** dhe nenit 40.2, shkronja **a** të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008, nenit 22, paragrafi 1,2 dhe nenit 49, paragrafi 4 të Ligjit mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, të nenit 5 pika **i** të Ligjit mbi Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës Nr.03/L-068, dhe nenit 36.2, shkronja **c** të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, Kuvendi i Komunës së Vitisë në seancën e mbajtur më datë 27.05.2014, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR SJELLJE DHE DISIPLINË TË NXËNËSVE PËR SHKOLLAT FILLORE DHE TË MESME TË ULËTA NË KOMUNËN E VITISË

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Përmes kësaj rregullore përcaktohen të drejtat, obligimet për të gjithë nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme të ulëta në Komunën e Vitisë, po ashtu kjo rregullore përcakton veprimet e ndaluara, kujdestarinë, stimulimin moral dhe material, masat edukativo-disiplinore dhe shqiptimi i tyre ndaj nxënësve.

Neni 2

Kjo rregullore i obligon të gjithë nxënësit që të kenë sjellje konformë saj, si brenda në shkollë, oborr shkollë, rrugë e në aktivitete që organizon shkolla.

Neni 3

Drejtori i shkollës dhe të gjithë mësimdhënësit janë të obliguar që të sigurojnë zbatimin e kësaj rregullore dhe për çdo situatë që bie ndesh me këtë ta trajtojnë konformë kësaj.

Neni 4

Të drejtat e nxënësit

1. E drejta për shkollim sipas dispozitave ligjore në fuqi.
2. E drejta të shfrytëzojë të gjitha format dhe mjetet të cilat i posedon institucioni edukativo- arsimor, punëtori, kabinetet, në realizimin e veprimtarisë edukativo- arsimore, praktikës profesionale dhe të arsimimit artistik.
3. Të dëgjojë dhe të jetë i dëgjuar, të adresoj ankesa dhe parashtrës në kutinë e ankesave dhe parashtrësve në shkollë.
4. Të shprehë mendimet dhe idetë e tij lidhur me çështjet që e preokupojnë.
5. Të jetë i informuar se çka pritet prej tij.
6. E drejta të zgjedhë dhe të jetë i zgjedhur në këshille të nxënësve dhe organet tjera.
7. E drejta të marrë pjesë në gara të diturisë, sportive dhe kulturore për të cilat edhe mund të shpërblehet nga shkolla, DKA-Viti, MASHT-i.

8. E drejta të avancohet në bazë të suksesit të përgjithshëm dhe talentit të dalluar në lëmi të veçanta sipas dispozitave ligjore në fuqi.
9. T'i respektohet dinjiteti moral dhe fizik.
10. T'i njihet e drejta ta shikoj testin dhe për padrejtësi që mendon që i është bërë të ankohet te drejtori i shkollës.
11. Të marrë dokumentin përkatës për klasën e kryer dhe dokumentet tjera të nevojshme për nxënësin të cilat shkolla i lëshon.
12. Të marrë mirënjohje dhe lëvdata dhe shpërblime tjera për sukseset e treguara në mësim, në gara të diturisë, në aktivitete të lira etj.
13. Në bazë të kërkesës së arsyeshme të prindit (nëse është nevoja dhe në dobi të nxënësit), drejtori i shkollës mund ti jep leje nxënësit deri në dy javë për të munguar nga mësimi - shkolla.

Neni 5

Obligimet e nxënësit

1. Të vijoj mësimin sipas orarit të përcaktuar nga institucioni edukativo-arsimor, obligohen të vijnë në shkollë 10 minuta para fillimit të orarit mësimor.
2. Të respektojë çdo ditë këtë rregullore të shkollës.
3. Të respektojë integritetin e personalitetin e secilit anëtar të personelit edukativo-arsimor dhe personelit tjetër.
4. Të jetë i përgatitur për mësim.
5. Ta ruaj inventarin e shkollës.
6. Ti arsyetojë mungesat në kohën e duhur.
7. Të vij në shkollë i pajisur me tekste dhe me mjete të domosdoshme mësimore.
8. Ti kryej detyrat dhe obligimet tjera të cilat i përcaktojnë organet profesionale dhe qeverisëse të shkollës.
9. Të ketë sjellje korrekte ndaj shokëve dhe shoqeve të klasës, të mbajë qëndrim të mirë në orë mësimore dhe në ambient shkollor.
10. Të tregojnë qetësinë dhe mirëkuptimin e tyre me rastin e organizimeve të kontrolleve të ndryshme për sigurinë e tyre nga ana e kujdestarëve të ditës.
11. Obligohet të mbajë higjienën vetjake, të kujdesen dhe të kontribuojë për higjienën e klasës, të shkollës dhe të ambientit të jashtëm të shkollës.

Neni 6

Veprimet e ndaluara të nxënësve

1. Duhani, për të gjithë (nxënësit, mësime të ndaluar dhe stafin tjetër) është i ndaluar në të gjitha ambientet e brendshme të shkollës (në lokale ku qëndrojnë nxënësit-mësonjëtorë, kabinete, bibliotekë, hollin e shkollës e të ngjashme) dhe në aktivitete jashtëmësimore, shëtitje, ekskursionet, piknikë etj.
2. Pijet alkoolike, sjellja dhe konsumimi i tyre brenda ambienteve shkollore janë të ndaluara për të gjithë komunitetin e shkollës.
3. E pa tolerueshme është sjellja dhe përdorimi në shkollë i mjeteve narkotike. Në rastet e tilla drejtori i shkollës njofton policinë dhe prindin e nxënësit-es.
4. Mjetet e forta armët e ftohta dhe të zjarrit, rreptësisht ndalohet ardhja në shkollë me mjete të forta (shufra hekuri, gome, druri, boksa të hekurt etj), armë të ftohta dhe armë zjarri. Në rastet e tilla obligativisht njoftohet policia dhe merren masa të tjera ndëshkuese konform legjislacionit dhe rregullave të shkollës.

5. Përdorimi i telefonave celular, gjatë orës mësimore dhe manipulimi me të në hapësira shkollore është i ndaluar për të gjithë mësimdhënësit dhe nxënësit. Nëse nxënësi përdor celularin gjatë orës mësimore i njëjti do ti merret dhe do ti dorëzohet prindit të tij.
6. Dëgjimi i muzikës apo i gjërave tjera gjatë orës mësimore nëpërmjet aparateve të ndryshme si dëgjuese të celularëve, vukmena etj.
7. Konsumimi i ushqimit në klasë, nxënësve të shkollës iu ndalohet konsumimi i ushqimit brenda orës mësimore, sikurse i farërave dhe gjërave të tjera të ngjashme. Me rastin e ngrënies së ndonjë ushqimi në shkollë janë të obliguar hedhurinat ti hedhin në vendin përkatës.
8. Veshjet, frizuart, nxënësit në shkollë, nuk duhet të veshin veshje (rroba) të tejdukshme, tejet të ngushta, të shkurtra, të cilat ekspozojnë pjesë të trupit, të mbajnë frizura dhe kapela të cilat identifikohen me grupe dhe organizata kriminale, në rastet e tilla njoftohet prindi i tij/saj. Sipas kushteve të aplikohet edhe bartja e uniformës së nxënësve (VI-IX).
9. Sjellja e të huajve në shkollë, nxënësve iu ndalohet të sjellin nxënës të shkollave tjera në shkollën e tyre, në oborr, si dhe jashtë oborrit shkollor. Një gjë e tillë lejohet vetë me marrëveshje paraprake në mes shkollave, me rastin e organizimeve të garave sportive, kulturore etj.
10. Nxënësve iu ndalohet shfaqja e të gjitha llojeve të dhunës, si: dhuna psikologjike, verbale, seksuale në të gjitha hapësirat e shkollës dhe jashtë saj, klasë, korridore, oborr, rrugë etj, me këtë rast njoftohet prindi i tij/saj.
11. Nxënësit janë të obliguar të respektojnë, mësimdhënësit, stafin teknik, stafin udhëheqës, sidomos shokët dhe shoqet në paralele dhe në gjithë shkollën. E patolerueshme është pengimi i procesit edukativo-arsimor. Konflikti verbal apo fizik në mes të nxënësve është i pa tolerueshëm dhe i dënueshëm.
12. Kopjimi gjatë punës me shkrim, nxënësit i ndalohet kopjimi gjatë punës që mësimdhënësit kanë organizuar me rastin e vlerësimit të tyre, gjatë fazave të testimit të tyre, shkrimeve të ndryshme etj.
13. Falsifikimi i dokumentacionit, nxënësit i ndalohet falsifikimi i dokumentacionit shkollor, qoftë vërtetime, dëftesa, po ashtu është i obliguar që ti ruaj librat shkollore të ndara falas nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në raste të tilla të njoftohen organet kompetente.
14. Nxënësit që qëllimisht vonohen për orë mësimore nuk ju lejohet hyrja në shkollë, deri në përfundimin e orës mësimore.
15. Ta lëshojë orën e mësimimit, i ndalohet nxënësit të lëshoj orën mësimore, vetëm me lejen e mësimdhënësit i lejohet një gjë e tillë.
16. Mungesa e pa arsyeshme, i ndalohet nxënësit që të mungoj pa arsye në shkollë.
17. Të shkatërroj inventarin shkollor, nëse nxënësi shkatërroi inventarin shkollor, mjetet mësimore apo ndonjë të mirë materiale të shkollës, prindi i tij është i obliguar të paguaj për dëmin në shumën që përcakton komisioni i caktuar nga ana e shkollës.
18. Qëndrimi pa nevojë në shkollë dhe në oborrin e shkollës, nxënësve iu ndalohet që të qëndrojnë pa nevojë në oborrin e shkollës si dhe në brendinë e shkollës pa ndonjë arsye.
19. Shkarravitja, gërvishtja, vizatimi, dëmtimi etj. i mureve, i inventarit e i pasurisë tjetër shkollore.

Neni 7

Kujdestaria e nxënësve në klasë

1. Nxënësit kujdestar dite në klasë, vijnë në shkollë së paku 15 minuta para fillimit të orarit mësimor. Duke bashkëpunuar me mësimdhënësit kujdestar dite, kujdesen për inventarin e klasës, pastërtinë e klasës, ajrosjen e klasës, kujdesen për mjete mësimore, pastrojnë dërrasën e zezë, kontrollojnë klasën a është pastruar nga punëtorët teknik dhe raportojnë te kujdestarët e ditës, arsimtarët.

2. Nxënësit kujdestar dite gjatë gjithë ditës kujdesen për rendin ditor në klasë, si dhe mbajnë shënime me rastin e vonesave të nxënësve dhe të arsimtarëve, si dhe janë përgjegjës për rendin ditor në klasë.
3. Gjatë pushimeve të shkurta ose të gjata kujdesen për qetësinë dhe rendin shtëpiak, iu tërheqin vërejtjen nxënësve, kurse ata të padëgjueshmit i lajmërojnë te arsimtari kujdestar i ditës, rastet e rënda edhe te drejtori i shkollës.
4. Mbledhin të gjitha gjërat që janë harruar nga ndërimi tjetër si: libra, fletore, lapsa, rroba e gjësende të tjera dhe i raportojnë arsimtarit kujdestar të ditës.
5. Pasi të përfundon mësimi bëjnë edhe një kontroll gjithë ambientit shkollor dhe njoftojnë arsimtarin kujdestar, nëse kanë hasur në ndonjë parregullsi ose dëme e informojnë edhe drejtorin ose sekretarin e shkollës, dhe të fundit e lëshojnë shkollën.
6. Nxënësit janë të obliguar që të respektojnë rendin dhe orarin ditor sipas **nenit 5, pika 5,1** si dhe orarin mësimor, poashtu për çdo parregullsi të njoftojnë kujdestarët e ditës dhe ti evidentojnë në fletoren e tyre të kujdestarisë.
7. Mësimdhënësit kujdestar dite janë të obliguar që të gjitha parregullsitë që ndodhin gjatë ditës të njoftojnë drejtorinë e shkollës si dhe ti evidentojnë në fletoren e tyre të kujdestarisë.
8. Kujdestarë dite –nxënësit i zgjedh secili kujdestar i klasës dhe qëndrojnë kujdestar vetëm për një ditë, pastaj zgjedhen me rotacion.

II. STIMULIMI MORAL DHE MATERIAL

Neni 8

1. Nxënësi gëzon të drejtën e stimulimit moral dhe material për rezultatet e larta të arritura në procesin edukativo-mësimor, në aktivitetet e ndryshme jashtëmësimore e shkollore, në aktivitetet me karakter garues në nivel shkolle, komune e vendi, për sjellje shembullore në shkollë dhe jashtë shkolle, si :
 - 1.1. lavdërim para kolektivit të klasës;
 - 1.2. lavdërim para kolektivit të shkollës;
 - 1.3. afishimi i fotografisë në tabelën “Nxënës të dalluar”;
 - 1.4. ndarja e Mirënjohjes për nxënës të dalluar;
 - 1.5. dhënia e certifikatës “Nxënës i dalluar”;
 - 1.6. dhënia e dhuratave të ndryshme, nga fondi i shkollës, DKA-së, pushtetit, komunës, sponsorët e ndryshëm, miq të shkollës, nga organizma, fondacione e shoqata të ndryshme bëmirese;
 - 1.7. dhënia e certifikatës: “Nxënësi i talentuar në lëmi të ndryshme” (psh në sport, matematikë, letërsi, etj.), për nxënës që fitojnë në kuize, gara, veprimtari të ndryshme artistike, sportive e të tjera të cilat organizohen nga DKA apo MASHT-i.

Neni 9

Lavdërimet, mirënjohjet dhe shpërblimet mund të jepen për: nxënësin personalisht , nxënësve të një paraleleje, nxënësve të një seksioni apo asociacioni dhe për shkollën në tërësi.

Neni 10

1. Për stimulimin në nënpikën 1.1 të **nenit 8** vendos mësuesi i klasës në nivelin një (kl. I-V), përkatësisht arsimtari kujdestar klase në nivelin dy (kl. VI-IX) ;

2. Për stimulimin në nënpikat 1.2 dhe 1.3 të **nenit 8** vendos drejtori i shkollës me propozimin e mësuesit, përkatësisht arsimtarit kujdestar dhe me propozimin e këshillit të nxënësve të shkollës.
3. Për stimulimin në nënpikat 1.4 dhe 1.5, të **nenit 8** vendos drejtori i shkollës, me propozimin e mësuesit, përkatësisht arsimtarit kujdestar klase, këshillit të nxënësve të shkollës dhe të këshillit të arsimtarëve të shkollës.
4. Për nënpikën 1.5 të **nenit 8**, nxënësi duhet të ketë sukses shembullor në mësim. Të dy këta stimulime (1.4 dhe 1.5) ndahen me ceremoni. Certifikatat (mirënjohjet) përgatiten dhe shpërndahen nga drejtorja e shkollës.
5. Për stimulimin në nënpikën 1.7, të **nenit 8** vendos DKA-ja, përkatësisht MASHT-i, varësisht se kush e organizon veprimtarinë (e kuizit të diturisë, garave etj.). Certifikatat apo mirënjohjet përgatiten dhe ndahen nga DKA-ja, përkatësisht MASHT-i me ceremoni.
6. Për të gjithë stimulimet morale e materiale shkolla mban evidencë të veçantë, përpos për stimulimit në nënpikën 1.1, të **nenit 8**.

III. MASAT EDUKATIVO-DISIPLINORE

Neni 11

1. Me rastin e shkeljeve të detyrave dhe obligimeve në shkollë, nxënësve iu shqiptohen këto masa disiplinore:
 - 1.1. **Vërejtje me gojë;**
 - 1.2. **Vërejtje me shkrim;**
 - 1.3. **Pezullim i përkohshëm nga garat, ekskursionet, vizitat, shëtitjet;**
 - 1.4. **Thyerja e notës së sjelljes;**
 - 1.5. **Ndërrimi i shkollës.**

Neni 12

Vërejtje me gojë, qortimi

1. I shqiptohet nxënësit për mos kryerjen e obligimeve të përcaktuara nga drejtuesit e shkollës, në rast të ndotjes së ambientit shkollor.
2. Për shkak veshjes së tij/saj.
3. kopjimit gjatë punës me shkrim.
4. fyerja e nxënësve tjerë në shkollë.
5. pranimin dhe sjelljen e personave të pa dëshiruar në shkollë.
6. shqetësimin që mund t'iu sjellë të tjerëve nëpërmjet zhurmës dhe sjelljeve jo të mira.
7. ngrënia e ushqimit gjatë orës mësimore, mos hedhja e hedhurinave në vendin e duhur nga ana e tyre.
8. Dëgjimi i muzikës ose gjërave të tjera gjatë orëve mësimore, përmes aparateve të ndryshme për dëgjim si vukmena, dëgjuese të telefonave celular, etj.
9. Këto masa i shqiptohen nxënësit nga kujdestari i klasës në prani të nxënësve të tjerë si dhe njoftohet prindi, këshilli i klasës dhe drejtori i shkollës.

Neni 13

Vërejtje me shkrim

1. I shqiptohet nxënësit për:

- 1.1. Pengimin e mësimit, mos ruajtja e librave shkollore të ndara falas nga MASHT;
- 1.2. Sjellje jo korrekte ndaj nxënësve dhe ndaj mësimitdhënësve;
- 1.3. Pirja e duhanit në hapësira shkollore;
- 1.4. Deri në 10 mungesa të pa arsyeshme, lëshimi i orës pa miratimin e mësimitdhënësit;
- 1.5. Përdorimi i telefonit mobil gjatë orës mësimore dhe manipulimi me të në hapësira shkollore;
- 1.6. Sjellja e të huajve në shkollë dhe në hapësirat jashtë saj;
- 1.7. Për të gjitha llojet e dhunës që e shfaqin si: dhunë verbale, rrahje mes vete, ngacmimi seksual dhe veprime të turpshme (puthje, përkëdhelje etj);
- 1.8. Përdorim të ditarit të klasës dhe notimi i vetes;
- 1.9. Qëndrimi pa nevojë në objektin shkollor dhe jashtë saj;
10. Për shkarravitje, gërvishtje, vizatime, dëmtime etj. të mureve, të inventarit e të pasurisë tjetër shkollore;
11. Vërejtja me shkrim lexohet para gjithë nxënësve të shkollës dhe një kopje e tillë i dërzohet prindit, si dhe një kopje do të qëndrojë 8 ditë në tabelën e shpalljeve në shkollë. Në rastet e përsëritjes së gabimeve të njëjta nxënësi transferohet në shkollë tjetër;
12. Këtë masë disiplinore e shqipton komisioni disiplinor i shkollës, drejtori i shkollës pas inicimit që bëhet nga kujdestari i klasës dhe Këshilli i Arsimitarëve;
13. Masa disiplinore qëndron në dosjen e nxënësit vetëm për një **(1) vit** shkollor.

Neni 14

Pezullim i përkohshëm nga garat ekskursionet, vizitat, shëtitjet

1. Kjo masë shqiptohet në rastet e:
 - 1.1. Prishjen e disiplinës gjatë organizimit të aktiviteteve të lira në shkollë dhe jashtë saj (psh. dita e shkollës, 28 Nëntori, Dita e mësuesit, kuize diturie etj);
 - 1.2. Moskryerjen e detyrave të dhëna nga mësimitdhënësit;
 - 1.3. Cenimin e dinjitetit të nxënësve tjerë;
 - 1.4. Përsëritja e shkeljeve të përcaktuara në këtë rregullore etj;
 - 1.5. Këtë masë disiplinore e shqipton drejtori i shkollës pas inicimit të kujdestarit të klasës së nxënësit.

Neni 15

Thyerja e notes së sjelljes

1. Nota e sjelljes i thyhet nxënësit në rastet e :
 - 1.1. Nxënësi i cili mungon pa arsye **10 deri në 25 orë** mësimi, i thyhet nota e **sjelljes në të mirë**;
 - 1.2. Nxënësi i cili mungon pa arsye **mbi 25 orë** mësimi, i thyhet nota e sjelljes **në jo të mirë**;
 - 1.3. Nxënësit mund t'i thyhet nota e sjelljes edhe për sjellje të keqe në shkollë, (mos respektimi i rregullave të shkollës, hyrjet dhe daljet nga klasa pa nevojë, mos respektimi i rendit shtëpiak që cakton institucioni ,vonesave për mësim, etj);
2. Këtë masë disiplinore e shqipton kujdestari i klasës, me ç' rast njoftohet edhe drejtori i shkollës.

Neni 16

Ndërrimi i shkollës

1. Ndërrimi i shkollës aplikohet në rastet e:
 - 1.1. Fyejnë arsimtarët ose punëtorët tjerë në shkollë dhe i pengojnë ata në kryerjen e detyrave në shkollë dhe jashtë saj;
 - 1.2. Pengojnë me qëllim nxënësit tjerë në mësim dhe në aktivitete jashtëmësimore;
 - 1.3. Falsifikojnë të dhënat në dokumente shkollore (në librin e klasës, libra amë, libreza apo dëftesa, etj);
 - 1.4. Vjedhin dhe shkatërrojnë dokumentacionin shkollor, pasurinë e nxënësve, të mësimdhënësve dhe pasurinë e shkollës;
 - 1.5. Sjellin në shkollë armë dhe lëndë plasëse, si dhe për sjelljen e të gjitha mjeteve që rrezikojnë shëndetin dhe sigurinë e nxënësve dhe personelit në shkollë;
 - 1.6. Paraqesin person tjetër në vend të tij dhe anasjelltas;
 - 1.7. Sjellin në shkollë dhe përdorin pije alkoolike dhe narkotike;
 - 1.8. Me rastin e shqiptimit të masës disiplinore për ndërrimin e shkollës së pari duhet të njoftohet DKA në Viti, pastaj me marrëveshje mes tyre dhe shkollave më të afërta nxënësi transferohet në shkollë tjetër. Vendimi i dorëzohet prindit të nxënësit;
 - 1.9. Kundër vendimit të drejtorit të shkollës për ndërrim të shkollës si dhe për çdo masë tjetër që iu është shqiptuar nxënësit, prindi ka të drejtë ankese në Këshillin e Arsimtarëve, Këshillin Drejtues të Shkollës, Drejtorinë Komunale të Arsimit në Viti në afatin prej **8 ditësh** prej ditës së pranimit të vendimit, (masës disiplinore);
 - 1.10. Të drejtën e inicimit të çfarëdo mase disiplinore kundër nxënësit e ka kujdestari i klasës. Me masat edukative-disiplinore që ndërmerren ndaj nxënësve, njoftohen prindërit e tyre;
 - 1.11. Masa disiplinore ndërrimi i shkollës mund të shqiptohet vetëm për nxënësit prej **klasës VI-të deri në klasën e IX-të**;
 - 1.12. Masa disiplinore qëndron në dosjen e nxënësit vetëm për një (1) vit shkollor.

IV.DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 17

Me rastin e ndonjë dispozite të kësaj rregullore që është në kundërshtim me ligjet apo udhëzimet administrative që do të nxirren nga MASHT-i, atëherë do të zbatohen ligjet, përkatësisht udhëzimet administrative të MASHT-it.

Neni 18

Obligohet secili kujdestarë që ta ketë këtë rregullore në çdo fillim të vitit shkollor dhe t'i njoftojë nxënësit me të, po ashtu një kopje e tillë duhet të vendoset në pjesën e njoftimeve në korridoret e të gjitha shkollave dhe të njoftohen prindërit me këtë Rregullore.

Neni 19

Për zbatimin e kësaj rregullore do të kujdesen të gjithë drejtorët e shkollave fillore dhe të mesme të ulëta në Komunën e Vitisë, si dhe **Drejtoria Komunale e Arsimit –Viti**.

Neni 20

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore shfuqizohet rregullorja **nr.013/5826** e miratuar më **16.12.2005,Viti.**

Neni 21

Obligohet secila shkollë që brenda tre muajve duhet të kenë rendin e vet shtëpiak, të cilin duhet ta aprovoj Këshilli Drejtues i Shkollës dhe e njehta të shfaqet në tabelat përkatëse për shpallje.

Neni 22

Kjo rregullore hyn ne fuqi menjëhere pas miratimit nga ana e Kuvendit Komunal.

KRYESUESI I KUVENDIT

Naim Pira

